FLETORJA ZYRTARE
E
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.2 27 janar 2004

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.9, datë 14.1.2004	Për miratimin e Marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Rumanisë, për bashkëpunim dhe asistencë të ndërsjellë administrative në çështjet doganore……	39
Vendim i KM nr.10, datë 14.1.2004	Për miratimin e Marrëveshjes, ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Polonisë, për bashkëpunim dhe asistencë të ndërsjellë në çështjet doganore……	45
Vendim i KM nr.13, datë 14.1.2004	Për miratimin në parim të Marrëveshjes së bashkëpunimit ekonomiko-teknik ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Popullore të Kinës…….	49
Vendim i KM nr.45, datë 22.1.2004	Për ndryshimin e tarifave të transportit qytetas të udhëtarëve….	50
Udhëzim i ILDKP nr.1, datë 13.1.2004	Për mënyrën e ngritjes dhe krijimit të inspektorateve të ulëta ..	51
Urdhër i ILDKP nr.1, datë 13.1.2004	Për miratimin e modelit të deklaratës së pasurisë dhe autorizimit përkatës……	52
Urdhër i ILDKP nr.2, datë 13.1.2004	Për miratimin e modelit të regjistrit themeltar alfabetik të subjekteve që mbartin detyrim për të deklaruar në Inspektoratin e Lartë dhe Inspektoratin e Ulët……	66

VENDIM
Nr.9, datë 14.1.2004

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË RUMANISË, PËR BASHKËPUNIM DHE ASISTENCË TË NDËRSJELLË ADMINISTRATIVE NË ÇËSHTJET DOGANORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 dhe 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Rumanisë për bashkëpunim dhe asistencë të ndërsjellë administrative në çështjet doganore.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË RUMANISË PËR BASHKËPUNIMIN DHE ASISTENCË TË NDËRSJELLË ADMINISTRATIVE NË ÇËSHTJET DOGANORE

Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Rumanisë, këtej e tutje referuar si "Palë Kontraktuese":

duke marrë në konsideratë që shkeljet doganore janë të dëmshme për interesat e tyre ekonomike, tregtare, financiare, shoqërore dhe kulturore;

duke marrë në konsideratë rëndësinë e vlerësimit të saktë dhe mbledhjen e detyrimeve doganore, taksave dhe pagesave të tjera në importimin dhe eksportimin e mallrave, si dhe për të siguruar zbatimin e duhur të dispozitave për masat ndaluese, kufizuese dhe kontrollin;

të bindur se veprimet e ndërmarra kundër shkeljeve doganore mund të jenë më efektive përmes bashkëpunimit të ngushtë midis administratave të tyre doganore;

të shqetësuar për shkallën e rritjes të tendencave të trafiqeve të paligjshme të drogave dhe substancave psikotrope dhe duke marrë në konsideratë se ato përbëjnë rrezik për shëndetin publik dhe shoqërinë;

duke marrë gjithashtu parasysh konventat ndërkombëtare të ngjashme në fuqi për inkurajimin nga Palët Kontraktuese të asistencës së ndërsjellë, si dhe rekomandimet e Organizatës Botërore të Doganave,

ranë dakord për sa më poshtë vijon:

Neni 1
Përkufizime

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje:

a) "Administratë doganore" do të nënkuptojë:

- për Republikën e Shqipërisë - Drejtoria e Përgjithshme e Doganave e Ministrisë së Financave;

- për Rumaninë - Autoriteti Kombëtar i Doganave të Autoritetit Kombëtar të Kontrollit.

b) "Legjislacion doganor" do të nënkuptojë dispozita të akteve normative në fuqi, që kanë të bëjnë me importimin, eksportimin, transitimin e mallrave ose çdo procedurë tjetër doganore që

lidhet me detyrimet doganore, taksat ose pagesat e tjera që mblidhen nga administratat doganore ose me masa të ndalimit, kufizimit dhe kontrollit të zbatueshëm nga administratat doganore.

c) "Shkelje doganore" do të nënkuptojë çdo shkelje të legjislacionit doganor, si dhe çdo përpjekje për të shkelur këtë legjislacion, siç është parashikuar në ligjet kombëtare të secilit shtet të Palës Kontraktuese.

d) "Pala Kontraktuese kërkuese" do të nënkuptojë administratën doganore, e cila bën një kërkesë për asistencë.

e) "Pala Kontraktuese e kërkuar" do të nënkuptojë administratën doganore prej së cilës kërkohet asistencë.

f) "Droga narkotike" do të nënkuptojë çdo substancë natyrale ose sintetike, të renditur në listën I ose listën II të Konventës së vetme mbi drogat narkotike hartuar në Nju-Jork më 30 mars 1961 (me ndryshimet përkatëse).

g) "Substanca psikotrope" do të nënkuptojë çdo substancë natyrale ose sintetike, të renditur në listën I, II, III, IV të Konventës për substancat psikotrope përgatitur në Vjenë, nën mbikëqyrjen e Kombeve të Bashkuara, më 21 shkurt 1971.

h) "Prekursorë" do të nënkuptojë substanca kimike të kontrolluara që përdoren për prodhimin e drogave dhe substancave psikotrope, të renditura në listat I dhe II të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër trafikut të paligjshëm të drogave narkotike dhe substancave psikotrope, adoptuar në Vjenë më 20 dhjetor 1988.

i) "Dërgesë e kontrolluar" do të nënkuptojë teknikën e lejimit të ngarkesave të paligjshme ose të dyshimta të drogave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve ose të substancave që zëvendësojnë ato, të kalojnë jashtë, përmes ose brenda territorit të një ose më shumë vendeve, me dijeninë dhe nën mbikëqyrjen e autoriteteve kompetente, me qëllim identifikimin e personave të përfshirë në kryerjen e shkeljeve.

Neni 2

Fushëmbulimi i Marrëveshjes

1. Palët Kontraktuese, në përputhje me dispozitat e parashikuara në këtë Marrëveshje, do të asistojnë njëra-tjetrën në sigurimin e dispozitave që janë parashikuar në legjislacionin doganor, si vijon:

a) do të ndërmarrin masat e nevojshme për të lehtësuar dhe përshpejtuar fluksin e mallrave dhe pasagjerëve;

b) do të bashkëpunojnë dhe asistojnë njëra-tjetrën në parandalimin dhe hetimin e shkeljeve të legjislacionit doganor;

c) kur kërkohet, do të sigurojnë informacione të tjera që do të shërbejnë për zbatimin e legjislacionit doganor;

d) do të përpiqen të bashkëpunojnë në gjetjen, zhvillimin dhe zbatimin e procedurave të reja doganore, në trajnimin dhe shkëmbimin e personelit dhe në çështje të tjera të interesit të përbashkët.

2. Asistenca e ndërsjellë, në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje, do të jepet në përputhje me legjislacionin në fuqi në territorin e shtetit të Palës Kontraktuese të kërkuar dhe brenda kompetencave dhe mundësive të saj.

Neni 3

Mbikëqyrja e personave, mallrave dhe mjeteve të transportit

Administratat doganore do të kryejnë, me iniciativën e tyre ose kur t'u kërkohet, kontrolle ose mbikëqyrje mbi:

a) persona që janë identifikuar ose dyshohen se kanë kryer shkelje doganore ose që janë përfshirë në trafikun e paligjshëm të drogave, substancave psikotrope dhe prekursorëve;

b) mallra që dihet ose që dyshohet se përdoren për kryerjen e shkeljeve doganore ose për qëllimet e trafikut të paligjshëm të drogave, substancave psikotrope dhe prekursorëve;

c) çdo mjet transporti që dihet ose dyshohet se përdoret për kryerjen e shkeljeve doganore ose për qëllimet e trafikut të paligjshëm të drogave, substancave psikotrope dhe prekursorëve;

d) pakot postare që dyshohet se përdoren në trafikun e paligjshëm.

Neni 4

Veprimet kundër trafikut të paligjshëm të mallrave të forta

Administratat doganore do të sigurojnë për njëra-tjetrën, me iniciativën e tyre ose kur t'u kërkohet, të gjitha informacionet përkatëse mbi qëllimin, ose kryerjen nga çdo person të shkeljeve të legjislacionit në fuqi në territorin e shtetit të një prej Palëve Kontraktuese, që lidhet me:

a) trafikun e drogave, substancave psikotrope dhe prekursorëve;

b) trafikun e armëve, municioneve, materialeve eksplozive dhe nukleare, si dhe çdo substancë tjetër të dëmshme për ambientin dhe shëndetin publik;

c) trafikun e veprave të artit me vlerë historike, kulturore dhe arkeologjike të rëndësishme;

d) trafikun e mallrave, objekt i detyrimeve të larta doganore dhe taksave.

Neni 5

Dërgesë e kontrolluar

1. Administratat doganore do të bashkëpunojnë, brenda kompetencave të tyre, në zbatimin e metodave për dërgesat e kontrolluara.

2. Vendimi për të zbatuar procedurën e dërgesave të kontrolluara do të bëhet sipas rastit, duke qenë në përputhje me legjislacionet në fuqi në territoret e shteteve të Palëve Kontraktuese.

Neni 6

Shkëmbimi i informacionit

1. Administratat doganore do të sigurojnë për njëra-tjetërën, me iniciativën e tyre ose kur t'u kërkohet, çdo informacion i cili mund të ndihmojë në zbatimin e procedurave më efikase lidhur me:

a) përcaktimin e vlerës doganore dhe certifikimin e dokumentacionit që paraqitet në importimin dhe eksportimin e mallrave, si dhe origjinalitetin e të dhënave paraqitur në to;

b) klasifikimin e mallrave që lidhen me aktivitetin e tregtisë së jashtme sipas tarifës doganore, si dhe kryerjen e analizave në laborator për qëllimet e klasifikimit tarifor të mallrave sipas krerëve;

c) përcaktimin e origjinës së mallrave dhe kontrollin e certifikatës së origjinës që paraqitet në eksport, si dhe kontrollin e procedurave doganore që zbatohen mbi mallrat në vendin e eksportit (transit nën mbikëqyrjen doganore, magazinimin doganor, lejimin e përkohshëm, zonat e tregtisë së lirë, eksport pas përpunimit aktiv etj.).

2. Administratat doganore do t'i sigurojnë njëra-tjetrës, kur t'u kërkohet, informacion lidhur me:

a) mallra të importuara në territorin e njërit prej shteteve të Palëve Kontraktuese, të cilat janë eksportuar në mënyrë të ligjshme nga territori i shtetit të Palës tjetër Kontraktuese;

b) mallra të eksportuara në territorin e njërit prej shteteve të Palëve Kontraktuese, të cilat janë importuar në mënyrë të ligjshme nga territori i shtetit të Palës tjetër Kontraktuese.

3. Administratat doganore do të sigurojnë për njëra-tjetrën, me inisiativën e tyre ose kur t'u kërkohet, çdo informacion që lidhet me shkeljet, siç është parashikuar në legjislacionin në fuqi në territoret e të dy shteteve dhe në veçanti informacion që lidhet me:

a) persona fizikë apo juridikë, që dihet ose që dyshohet se kanë kryer shkelje doganore ose janë përfshirë në trafikun e paligjshëm të drogave, substancave psikotrope dhe prekursorëve ose të çdo malli të ndaluar apo të kufizuar;

b) mallra që dihet ose dyshohet se janë objekt i shkeljeve doganore ose të trafikut të paligjshëm të drogave, substancave psikotrope dhe prekursorëve;

c) mjete transporti që dihet ose dyshohet se përdoren për kryerjen e shkeljeve doganore ose në trafikun e paligjshëm të drogave, substancave psikotrope dhe prekursorëve.

4. Në rast se administrata doganore e kërkuar nuk e disponon informacionin e kërkuar, ajo duhet të marrë masat e nevojshme për të siguruar këtë informacion brenda kompetencave dhe nga burimet e saj në dispozicion, si të vepronte për interesat e saj dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi në territorin e atij shteti.

5. Administrata doganore e njërës prej Palëve Kontraktuese do të sigurojë, me iniciativën e saj ose kur t'i kërkohet, për administratën doganore të Palës tjetër Kontraktuese dokumentet doganore, dokumentet e transportit, materialet e provave dhe kopjet e tyre të vërtetuara, si dhe informacion mbi veprimet e kryera ose që planifikohet të kryhen, të cilat përbëjnë ose mund të përbëjnë shkelje të legjislacionit doganor në fuqi në territorin e shtetit tjetër.

6. Informacioni që i jepet administratës doganore të Palës tjetër Kontraktuese mund të transmetohet nëpërmjet mjeteve elektronike në vend të dokumenteve të specifikuara në këtë Marrëveshje. Ai duhet të përmbajë shpjegimet e nevojshme për interpretimin dhe përdorimin e këtij informacioni.

Neni 7

Format dhe përmbajtja e kërkesës për asistencë

1. Kërkesat që do të paraqiten në kuadrin e Marrëveshjes do të bëhen me shkrim. Kërkesat do të përmbajnë dokumente të bashkëngjitura, të nevojshme për realizimin e kërkesës. Në raste të veçanta, kërkesat mund të bëhen gojarisht, por do të konfirmohen me shkrim maksimumi brenda 3 ditëve.

2. Kërkesat sipas paragrafit (1) të këtij neni do të përmbajnë informacionin e mëposhtëm:

a) emrin e administratës doganore që e bën kërkesën;

b) masat e kërkuara;

c) objektin dhe arsyet për të cilat bëhet kërkesa;

d) ligjin dhe aktet e tjera ligjore të cilave iu referohet objekti;

e) të dhëna sa më të sakta dhe të detajuara për personat fizikë ose juridikë, që janë përfshirë në hetim;

f) një përmbledhje të fakteve që lidhen me objektin e kërkesës;

g) një komplet të kopjeve të certifikuara të dokumenteve doganore, tregtare dhe të transportit.

3. Kërkesa do të paraqitet në gjuhën zyrtare të shtetit të Palës Kontraktuese të kërkuar ose në anglisht.

4. Në rast se një kërkesë nuk përmbush kërkesat e paragrafit (2) dhe (3) të këtij neni, atëherë do të kërkohet ndryshimi i saj.

Neni 8

Hetimet doganore

1. Në rast se administrata doganore e njërës prej Palëve Kontraktuese e kërkon, administrata doganore e Palës tjetër Kontraktuese do të fillojë një hetim të veprimeve, të cilat kanë shkelur ose mund të shkelin legjislacionin doganor në fuqi në territorin e shtetit të Palës Kontraktuese kërkuese. Ajo do t'ia bëjë të ditur rezultatet e hetimit Palës Kontraktuese kërkuese.

2. Këto hetime do të kryhen sipas legjislacionit në fuqi në territorin e shtetit të Palës Kontraktuese të kërkuar. Pala Kontraktuese e kërkuar do të procedonte njësoj sikur të vepronte për interesat e saj.

3. Zyrtarët e administratës doganore të njërës Palë Kontraktuese mund, në raste të veçanta, me pëlqimin e administratës doganore të Palës tjetër Kontraktuese, të jenë të pranishme në territorin e shtetit të këtij të fundit për hetimin e shkeljeve të legjislacionit doganor të shtetit përkatës. Ata duhet të provojnë statusin e tyre zyrtar.

4. Një zyrtar i Palës Kontraktuese kërkuese i pranishëm në territorin e shtetit të Palës Kontraktuese së kërkuar sipas paragrafit (3) do të kryejë vetëm veprimtari këshillimore dhe nuk do të marrë pjesë aktivisht në asnjë rast në hetim, as nuk do të takohet me njerëzit që janë duke u pyetur dhe as nuk duhet të marrë pjesë në asnjë veprimtari hetimi.

Neni 9

Përdorimi i informacionit dhe i dokumentacionit

1. Informacioni, dokumentet dhe të dhënat e marra në kuadrin e kësaj Marrëveshje nuk do të përdoren për qëllime të tjera nga ato të specifikuara në këtë Marrëveshje. Ato mund të përdoren për qëllime të tjera vetëm me aprovimin me shkrim të administratës doganore, e cila e ka ofruar atë informacion.

2. Informacionet dhe dokumentet që kanë të bëjnë me trafikun e paligjshëm të drogave, substancave psikotrope dhe prekursorëve mund t'u jepen autoriteteve të tjera qeveritare të shtetit të Palëve Kontraktuese, të cilat merren me aktivitetet e kontrollit të abuzimit me drogën dhe trafikun e përgjithshëm të drogave, substancave psikotrope dhe prekursorëve.

3. Çdo kërkesë e bërë, si dhe informacionet e dhëna në çfarëdolloj mënyre sipas kësaj Marrëveshjeje do të jenë të një natyre konfidenciale. Ato do të mbahen në mënyrë konfidenciale dhe do të gëzojnë të paktën të njëjtën mbrojtje që gëzon i njëjti informacion dhe dokumentacion sipas legjislacionit në fuqi në territorin e shtetit të Palës Kontraktuese të kërkuar.

4. Administrata doganore, e cila ka marrë informacionin dhe dokumentet në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje, mund, në varësi të synimeve dhe qëllimit, ta përdorë këtë informacion si provë gjatë procedimeve administrative dhe ligjore.

5. Ky dokumentacion dhe informacion mund të përdoret si provë në gjyq dhe statusi i tyre ligjor do të përcaktohet në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi në territorin e shtetit të Palës Kontraktuese që ka marrë informacionin.

Neni 10

Ekspertët dhe dëshmitarët

1. Kur të kërkohet, Pala Kontraktuese e kërkuar mund të autorizojë zyrtarët e saj, me pëlqimin e tyre, të veprojnë si ekspertë ose dëshmitarë përpara autoriteteve ligjore dhe administratave të Palës Kontraktuese kërkuese. Këta zyrtarë do të japin prova të siguruara gjatë kryerjes së detyrës së tyre.

2. Administrata doganore kërkuese është e detyruar të marrë të gjitha masat e nevojshme për sigurinë e zyrtarëve gjatë qëndrimit të tyre në territorin e shtetit të saj, sipas paragrafit (1) të këtij neni. Transporti dhe shpenzimet ditore të këtyre zyrtarëve do të mbulohen nga administrata doganore kërkuese.

3. Kërkesa për paraqitjen e këtyre zyrtarëve duhet të përshkruajë me saktësi se cili është rasti dhe se në çfarë statusi duhet të paraqiten zyrtarët.

4. Kërkesa për prezencën e zyrtarëve doganore si ekspertë dhe dëshmitarë do të bëhet në përputhje me legjislacionin e shtetit të Palës Kontraktuese të kërkuar.

Neni 11

Përjashtime nga detyrimi për të dhënë asistencë

1. Në rast se Pala Kontraktuese e kërkuar e konsideron përmbushjen e kërkesës të dëmshme për sovranitetin, sigurinë ose për interesa të tjera të rëndësishme për shtetin e saj, ajo mund të refuzojë të japë asistencën e kërkuar në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje, plotësisht ose pjesërisht, ose dhënia e asistencës së kërkuar mund të bëhet në bazë të disa kushteve të caktuara.

2. Në rast se Pala Kontraktuese kërkuese kërkon asistencë të cilën ajo vetë nuk do të ishte në gjendje t'ia ofronte administratës doganore të Palës tjetër Kontraktuese, këtë fakt ajo duhet ta përmendë në kërkesë. Përmbushja e një kërkese të tillë do të jetë në gjykimin e Palës Kontraktuese të kërkuar.

3. Në rast se asistenca refuzohet, arsyet për refuzimin do t'i njoftohen me shkrim dhe pa vonesë Palës Kontraktuese kërkuese.

Neni 12
Thjeshtëzimi i procedurave doganore

Administratat doganore do të ndërmarrin, siç është rënë dakord bashkërisht, masat e nevojshme për thjeshtimin e procedurave doganore, në mënyrë që të lehtësohet dhe përshpejtohet lëvizja e mallrave midis territoreve të shteteve të Palëve Kontraktuese.

Neni 13
Asistenca teknike

Administratat doganore mund të sigurojnë asistencë teknike për njëra-tjetrën në lidhje me çështjet doganore, si vijon:

a) shkëmbimin e zyrtarëve doganorë, në mënyrë që të paraqesin para tyre mënyrat e avancuara për kontrollin doganor;

b) shkëmbim informacioni dhe aftësish në përdorimin e pajisjeve teknike të kontrollit;

c) trajnim dhe ritrajnim të zyrtarëve doganorë;

d) shkëmbimin e specialistëve në çështjet doganore;

e) shkëmbimin e të dhënave specifike, shkencore dhe teknike, që lidhen me zbatimin e dispozitave doganore.

Neni 14
Shpenzimet

Palët Kontraktuese do të heqin dorë nga të gjitha pretendimet për njëra-tjetrën për rimbursimin e shpenzimeve si pasojë e ekzekutimit të kësaj Marrëveshjeje, me përjashtim të shpenzimeve për specialistët dhe dëshmitarët, si dhe përkthyesit dhe interpretuesit, të cilët nuk varen nga shërbimet publike.

Neni 15
Zbatimi i Marrëveshjes

1. Bashkëpunimi dhe asistenca reciproke, të parashikuara në këtë Marrëveshje, do të ofrohen nga administratat doganore të Palëve Kontraktuese. Këto autoritete do të bien dakord bashkërisht për dokumentet që do të shërbejnë për këtë qëllim.

2. Përfaqësuesit e administratave doganore të Palëve Kontraktuese do të takohen kur të jetë e nevojshme, me rradhë në të dy Shtetet, për të analizuar zbatimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, si dhe të zgjidhin çështje të tjera praktike të bashkëpunimit dhe asistencës së ndërsjellë të administratave doganore të Palëve Kontraktuese.

3. Administratat doganore të Palëve Kontraktuese do të përcaktojnë bashkërisht metodat e zbatimit praktik të kësaj Marrëveshjeje.

4. Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, administratat doganore të Palëve Kontraktuese do të caktojnë zyrtarët ndërlidhës dhe do të shkëmbejnë listat ku do të tregohen emrat, pozicionet, numrat e telefonit dhe të faksit të këtyre zyrtarëve, brenda dy muajve pasi Marrëveshja të ketë hyrë në fuqi. Ato gjithashtu mund të vendosin kontakte të drejtpërdrejta midis strukturave të tyre të hetimit.

Neni 16
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje e dalë gjatë zbatimit dhe interpretimit të kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet nëpërmjet konsultimeve ndërmjet administratave doganore të Palëve Kontraktuese.

Mosmarrëveshja që nuk mund të zgjidhet nëpërmjet konsultimeve ndërmjet administratave doganore do të zgjidhet nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Neni 17
Hyrja në fuqi

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi tridhjetë ditë pas datës së marrjes së njoftimit të fundit, me anë të të cilit Palët Kontrakuese informojnë njëra-tjetrën, nëpërmjet kanaleve diplomatike, se të gjitha kërkesat ligjore kombëtare për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshje janë përmbushur.

2. Kjo Marrëveshje është parashikuar për një periudhë të pakufizuar kohore.

3. Secila Palë Kontraktuese mund ta denoncojë Marrëveshjen me anë të një njoftimi me shkrim, që do t'i dërgohet Palës tjetër Kontraktuese nëpërmjet kanaleve diplomatike. Marrëveshja do të përfundojë brenda tre muajve nga data e marrjes së njoftimit përkatës.

Firmosur në Bukuresht më datë 19 nëntor 2003 në dy kopje origjinale në gjuhët rumanisht, shqip dhe anglisht, ku të gjitha kopjet janë njësoj autentike. Në rast të devergjencave midis teksteve shqip dhe rumanisht, teksti në anglisht do të merret për bazë.

VENDIM
Nr.10, datë 14.1.2004

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË POLONISË PËR BASHKËPUNIM DHE ASISTENCË TË NDËRSJELLË NË ÇËSHTJET DOGANORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 17 dhe 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Polonisë për bashkëpunim dhe asistencë të ndërsjellë në çështjet doganore.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

MARRËVESHJE
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË POLONISË, PËR BASHKËPUNIM DHE ASISTENCË TË NDËRSJELLË NË ÇËSHTJET DOGANORE

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Polonisë, këtej e tutje referuar si "Palë Kontraktuese",

duke dëshiruar të zhvillojnë bashkëpunimin në çështjet doganore dhe duke njohur rëndësinë e asistencës së ndërsjellë ndërmjet autoriteteve doganore;

duke konsideruar se shkeljet e legjislacionit doganor janë të dëmshme për interesat sociale, ekonomike dhe tregtare të vendeve të tyre;

duke konsideruar se trafiku i paligjshëm i lëndëve narkotike dhe substancave psikotrope shkakton dëmtim të interesave sociale të eksportimit të tyre;

duke konsideruar rëndësinë e sigurimit të përcaktimit të saktë të detyrimeve doganore dhe detyrimeve të tjera të grumbulluara gjatë importimit apo eksportimit të mallrave dhe zbatimin e saktë të dispozitave të ligjit doganor mbi ndalimet, kufizimet dhe kontrollin;

duke marrë në konsideratë rekomandimet e Këshillit të kooperimit doganor mbi asistencën e ndërsjellë administrative të 5 dhjetorit 1953,

ranë dakord për sa më poshtë vijon:

Neni 1

Përcaktime

Termat e mëposhtëm të përdorur në Marrëveshje shpjegohen si:

1. "Ligje doganore"- dispozitat ligjore në fuqi në territoret e Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Polonisë në lidhje me importimin, eksportimin dhe transitimin e mallrave, si dhe detyrimet doganore dhe taksat e tjera, si dhe masat e ndalimit, kufizimit dhe kontrollit të ushtruara nga autoritetet doganore;

2. "Autoritet Doganore"- për Republikën e Shqipërisë: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave e Ministrisë së Financave dhe për Republikën e Polonisë: Ministri i Financave;

3. "Detyrimet doganore"- çdo detyrim doganor dhe taksa të tjera të përcaktuara dhe të grumbulluara, bazuar në ligjet doganore;

4. "Autoriteti Kërkues"- Autoriteti doganor, i cili bën një kërkesë për asistencë në çështjet doganore;

5. "Autoriteti i Kërkuar"- Autoriteti doganor, i cili merr një kërkesë për asistencë në çështjet doganore;

6. "Shkelje të ligjeve doganore"- çdo dhunim ose tentativë për dhunim të ligjeve doganore;

7. "Person"- një person fizik ose juridik, ndërsa në Republikën e Polonisë, gjithashtu edhe njësi të cilat nuk kanë personalitet legal, të vendosura në përputhje me legjislacionin në fuqi, që kryejnë import ose eksport mallrash për në territorin doganor të shteteve të Palëve Kontraktuese;

8. "Lëndë narkotike"- substancat e përmendura në listën e Konventës standarde të lëndëve narkotike të 1961, kryer në Nju-Jork më 30 mars 1961 dhe Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër trafikut të paligjshëm të lëndëve narkotike dhe substancave psikotrope, kryer në Vjenë më 20 dhjetor 1988.

9. "Substanca psikotrope"- substancat e përmendura në listën e Konventës mbi substancat psikotrope, kryer ne Vjenë më 21 shkurt 1971.

Neni 2

Fushëveprimi i marrëveshjes

1. Autoritetet Doganore, në përputhje me dispozitat e përcaktuara në këtë Marrëveshje, do t'i mundësojnë njëra-tjetrës asistencë me synim që:

a) të sigurohen se ligjet doganore janë zbatuar saktësisht;

b) të investigohen, të parandalohen dhe të goditen shkeljet e legjislacionit doganor;

c) të grumbullohen dhe të përcaktohen me saktësi detyrimet doganore;

d) të shkëmbejnë informacion dhe dokumente, lidhur me zbatimin e legjislacionit doganor;

e) të trajnohen dhe të zhvillojnë aftësitë profesionale të punonjësve doganorë dhe të familjarizohen ata me pajisjet teknike të përdorura nga shërbimet doganore;

f) asistenca brenda kuadrit të kësaj Marrëveshjeje do të jepet në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe brenda kompetencave dhe burimeve të Autoritetit të Kërkuar. Nëse është e nevojshme, Autoriteti i Kërkuar mund të rregullojë që asistenca të mundësohet nga një autoritet tjetër kompetent.

Neni 7

Kontrolli i personave, mallrave dhe mjeteve të transportit

Autoritetet Doganore, sipas kërkesës, do të kryejnë mbikëqyrjen mbi:

a) persona për të cilët ka prova ose dyshime se kanë shkelur ose janë duke shkelur legjislacionin doganor;

b) mallra për të cilat importi, eksporti ose transiti i tyre mund të sjellë shkelje të legjislacionit doganor;

c) mjete transporti dhe kontenierë për të cilat ka prova ose dyshime se janë përdorur apo mund të përdoren në shkeljen e legjislacionit doganor.

Neni 8

Bashkëpunimi teknik

Bashkëpunimi teknik i Autoriteteve Doganore në fushën e çështjeve doganore do të përfshijë:

a) shkëmbimin e punonjësve të doganës ose ekspertëve, kur kjo ka interes reciprok për qëllime të avancimit të përdorimit të teknikave doganore të njëri-tjetrit;

b) shkëmbimin e informacionit dhe eksperiencave në përdorimin e pajisjeve detektuese;

c) shkëmbimin e të dhënave profesionale dhe teknike, lidhur me zbatimin e legjislacionit doganor.

Neni 9

Ekzekutimi i kërkesës

1. Autoriteti i Kërkuar do të nisë kërkime zyrtare, lidhur me operacione të cilat janë në kundërshtim me legjislacionin doganor. Ai do t'i komunikojë rezultatet e këtij hartimi autoritetit kërkues.

2. Autoriteti i kërkuar mund të lejojë punonjësit e doganës të autoritetit kërkues të marrin pjesë në hetimet e përmendura në paragrafin 1.

3. Autoritetet Doganore, sipas kërkesës, mund të autorizojnë punonjësit e tyre të paraqiten si ekspertë ose dëshmitarë në proceset penale ose administrative të kryera në territorin e shtetit të Palës tjetër Kontraktuese brenda autorizimit të dhënë nga Autoritetet Doganore dhe për rastet e mbuluara nga kjo Marrëveshje. Kërkesa për paraqitje duhet të pasqyrojë qartë se për çfarë çështje dhe me çfarë kapaciteti do të paraqitet ky punonjës.

4. Kur në rastet e parashikuara në këtë Marrëveshje punonjësit doganorë do të jenë prezent në territorin e shtetit të Palës tjetër Kontraktuese, ata në çdo kohë të jenë në gjendje të paraqesin prova të pozicionit të tyre zyrtar. Ata nuk duhet të veshin uniformë dhe as të mbajnë armë.

Neni 10

Përdorimi i informacionit dhe i dokumenteve

1. Informacioni dhe dokumentet e marra sipas kësaj Marrëveshjeje nuk do të përdoren për qëllime të tjera veç atyre të specifikuara në këtë marrëveshje pa miratimin me shkrim të Autoritetit Doganor që i ka dërguar ato. Dispozitat nuk do të jenë të zbatushme për informacionet dhe dokumentet që kanë të bëjnë me shkelje të legjislacionit doganor, lidhur me lëndët narkotike dhe substancat psikotrope.

2. Autoriteti që merr informacionin dhe dokumentet do t'u garantojë atyre nivelin e duhur të konfidencialitetit, në përputhje me legjislacionin kombëtar të këtij shteti dhe në përputhje me karakterin individual të çdo rasti.

3. Autoritetet Doganore të Palëve Kontraktuese, për shkak të fushës së mbulimit dhe nivelit të kësaj Marrëveshjeje do ta përdorin informacionin dhe dokumentet e marra sipas kësaj marrëveshjeje në proceset penale dhe administrative.

Neni 11
Kërkesa për asistencë

1. Kërkesat në zbatim të kësaj Marrëveshjeje do të bëhen me shkrim. Dokumentet e nevojshme për ekzekutimin e një kërkese të tillë duhet të bashkëshoqërojnë kërkesën. Kërkesat urgjente mund të bëhen me gojë. Ato duhet të konfirmohen me shkrim sa më shpejt të jetë e mundur.

2. Kërkesat e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni do të përfshijnë informacionin e mëposhtëm:

a) Autoritetin Doganor që bën kërkesën;

b) natyrën e procesit;

c) objektin e kërkesës;

d) ligjet dhe faktet që justifikojnë kërkesën;

e) emrat dhe adresat e personave që kanë të bëjnë me procesin, nëse dihen;

f) një përshkrim të shkurtër të çështjes që trajtohet, si dhe elementet ligjore të përfshira.

3. Kërkesa duhet të dërgohet në anglisht ose në një gjuhë tjetër të pranueshme nga Autoriteti i Kërkuar.

4. Nëse kërkesa nuk i përmbush standardet formale të përmendura në paragrafët 1, 2 ose 3, Autoriteti i Kërkuar mund të kërkojë korrektimin ose kompletimin e kërkesës.

5. Kërkesa për korrektimin ose kompletimin e kërkesës së përmendur në paragrafin 4 duhet të bëhet jo më vonë se dy muaj nga data e marrjes së kërkesës.

Neni 12
Përjashtime nga detyrimi për të dhënë asistencë

1. Nëse Autoritetet i Kërkuar është i mendimit se përgjigja ndaj një kërkese mund të bjerë ndesh me sovranitetin, sigurinë, rendin publik, interesat ekonomike ose interesa të tjera themelore të shtetit të vet, asistenca mund të refuzohet, e tëra ose pjesërisht, ose mund të përmbushet vetëm në bazë të respektimit të disa kushteve të caktuara.

2. Nëse Autoriteti Doganor bën një kërkesë për asistencë, i cili vetë nuk do të mund ta përmbushte nëse i kërkohej diçka e tillë, kjo gjë duhet të theksohet në kërkesë. Në këtë rast varet nga Autoriteti i Kërkuar vendimi nëse do t'i përgjigjet një kërkese të tillë.

3. Nëse asistenca refuzohet, shkaqet për refuzimin duhet t'i njoftohen me shkrim Autoritetit Kërkues pa vonesë.

Neni 13
Shpenzimet

1. Palët Kontraktuese do të heqin dorë nga çdo kërkesë për rimbursimin e shpenzimeve të dala gjatë vënies në zbatim të Marrëveshjes në fjalë, me përjashtim të shpenzimeve lidhur me dëshmitarët, ekspertët, dhe shpenzimet për përkthyesit që nuk janë punonjës shtetërorë.

2. Shpenzimet jo të zakonshme që rezultojnë nga bashkëpunimi teknik i përmendur në paragrafin 1 do të jetë objekt i rregullimeve të veçanta ndërmjet Autoriteteve Doganore të Palëve Kontraktuese.

Neni 14
Dhënia e asistencës

1. Marrëveshja në fjalë do të zbatohet direkt ndërmjet Autoriteteve Doganore. Rregullimet implementuese që specifikojnë detajet e bashkëpunimit të realizuar sipas Marrëveshjes në fjalë mund të konkludohen ndërmjet Autoriteteve Doganore të Palëve Kontraktuese.

2. Palët Kontraktuese, me konsensus të ndërsjellë, do të përpiqen të zgjidhin problemet ose dyshimet që rezultojnë nga interpretimi ose zbatimi i Marrëveshjes në fjalë.

Neni 15
Zbatimi territorial

Kjo Marrëveshje do të zbatohet në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë dhe në territorin doganor të Republikës së Polonisë.

Neni 16
Hyrja në fuqi dhe përfundimi

Palët Kontraktuese do t'i konfirmojnë njëra-tjetrës nëpërmjet shkëmbimit të notave diplomatike se të gjitha kërkesat ligjore kombëtare të shteteve të veta, të nevojshme për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes, janë përmbushur. Marrëveshja do të hyjë në fuqi në ditën e tridhjetë pas marrjes së notës së fundit.

Neni 17

Kjo Marrëveshje është menduar të jetë e pakufizuar në kohë. Mund të përfundojë nëpërmjet njoftimit të njërës prej Palëve Kontraktuese; në këtë rast Marrëveshja do të pushojë se qeni në fuqi 6 muaj pas datës së përfundimit.

E nënshkruar në Tiranë, më 12.11.2003, në dy origjinale, secila në gjuhët shqip, polonisht dhe anglisht, ku të gjitha tekstet janë njëlloj autentike. Në rast divergjencash përkthimi të dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, do të mbizotërojë teksti në gjuhën angleze.

VENDIM
Nr.13, datë 14.1.2004

PËR MIRATIMIN NË PARIM TË MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT EKONOMIKO-TEKNIK NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS POPULLORE TË KINËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 7 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin, në parim, të Marrëveshjes së bashkëpunimit ekonomiko-teknik ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Popullore të Kinës.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

MARRËVESHJE
PËR BASHKËPUNIMIN EKONOMIKO-TEKNIK NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS POPULLORE TË KINËS

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Popullore të Kinës, për të zhvilluar më tej marrëdhëniet e bashkëpunimit miqësor dhe bashkëpunimin ekonomiko-teknik midis dy vendeve, bien dakord sa më poshtë vijon:

Neni 1

Sipas nevojave të Qeverisë së Republikës të Shqipërisë, Qeveria e Republikës Popullore të Kinës i jep një ndihmë falas Qeverisë së Republikës të Shqipërisë me vlerë prej 15 milionë yuan RMB.

Neni 2

Ndihma e sipërpërmendur përdoret për objekt të bashkëpunimit ekonomiko-teknik ose për mallra të zakonshme të rakorduara nga qeveritë e të dy vendeve. Çështjet konkrete do të caktohen në marrëveshje të tjera të nënshkruara nga të dyja Palët.

Neni 3

Modalitetet teknike bankare, që kanë lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, do të nënshkruhen nga Banka e Kinës dhe një bankë e caktuar nga Qeveria shqiptare.

Neni 4

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi nga data e nënshkrimit të të dyja Palëve dhe do të jetë e vlefshme deri sa të dyja qeveritë të përmbushin të gjitha detyrimet e përcaktuara në këtë Marrëveshje.

Kjo Marrëveshje nënshkruhet në Tiranë më……në dy kopje origjinale, ku secila Palë mban një kopje. Çdo kopje shkruhet në gjuhën shqipe dhe në gjuhën kineze, duke pasur të dyja tekstet fuqi të barabartë.

VENDIM
Nr.45, datë 22.1.2004

PËR NDRYSHIMIN E TARIFAVE TË TRANSPORTIT QYTETAS TË UDHËTARËVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 4 dhe 5 të ligjit nr.7581, datë 7.7.1992 "Për çmimet dhe tarifat", me propozimin e Ministrit të Financave dhe Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Tarifat e transportit të udhëtarëve, të caktuarA në shkronjën "a" të pikës 1 të vendimit nr.146, datë 26.2.1998 të Këshillit të Ministrave "Për ndryshimin e tarifave të transportit të udhëtarëve",ndryshohen si më poshtë vijon:

Tarifat e transportit qytetas të udhëtarëve, me autobus, në linjat me largësi deri në 9 km, caktohen: 20 lekë për një udhëtim vajtje ose kthim, 600 lekë për një biletë pajtimi mujor linjë, 800 lekë për një biletë pajtimi mujor të përgjithshëm, për të gjitha linjat brenda qytetit, për qytetarët dhe

400 lekë për një biletë pajtimi mujor të përgjithshëm, për të gjitha linjat brenda qytetit, për nxënësit dhe studentët. Bashkitë, në varësi të masës dhe të mënyrës së subvencionimit, përcaktojnë numrin dhe mënyrën e shpërndarjes së biletave të pajtimit mujor.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 shkurt 2004.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

UDHËZIM
Nr.1, datë 13.1.2004

PËR MËNYRËN E NGRITJES DHE KRIJIMIT TË INSPEKTORATEVE TË ULËTA

Në mbështetje të nenit 17 e 23 të ligjit nr.9049, datë 10.4.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve finaciare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publik",

UDHËZOJ:

1. Inspektoratet e ulëta të krijohen sipas mënyrës së parashikuar në nenin 18 të ligjit nr.9049, datë 10.4.2003.

2. Titullari i institucionit të administratës publike në nivelin qendror apo vendor, institucionet e pavarura, organet e pushtetit vendor, prefekti i qarkut, bankat dhe institucionet financiare shoqërore, korporatat e shndërruara në shoqëri ose jo anonime, ku pjesëmarrja e shtetit është mbi 50%, për të ngritur dhe krijuar inspektoratet e ulëta duhet të mbajnë parasysh këto kritere:

- Institucionet qendrore duhet të krijojnë inspektoratet e ulëta me një numër tek, në mënyrë që vendimmarrja të jetë e shpejtë dhe efektive.
- Inspektoratet e ulëta duhet të kenë një numër anëtarësh në raport me numrin e subjekteve që do të deklarojnë pasurinë dhe detyrimet financiare, duke krijuar mundësi menaxhimi dhe vetëveprimi.

3. Në rastet kur pranë institucioneve të varësisë së institucioneve të administratës qendrore, degëve, filialeve apo njësive të tyre janë ngritur inspektoratet e ulëta dhe numri i tyre është më i lartë se kriteret e përcaktuara në këtë udhëzim, atëherë titullari i institucionit qendror duhet të rishikojë aktin e ngritjes së këtij inspektorati, në përputhje me këtë udhëzim, brenda 14 ditëve nga botimi i këtij udhëzimi në Fletoren Zyrtare.

4. Në përputhje me nenin 18 të ligjit, këshillat e qarqeve të marrin masa për ngritjen dhe funksionimin e inspektorateve të ulëta. Kryetarët e këshillave të qarqeve duhet të përcaktojnë edhe subjektet që do të deklarojnë pasurinë për bashkitë dhe komunat që kanë në juridiksion, në përputhje me nenin 3 pika 2 të ligjit dhe në bashkëpunim edhe me kryetarët e bashkive dhe të komunave.

5. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi titullarët e institucioneve të administratës publike në nivel qendror apo vendor, të instutucioneve të pavarura, organeve të pushtetit vendor, prefektët e qarkut, bankave dhe institucioneve financiare shoqërore, korporatave të shndërruara në shoqëri ose jo anonime, ku pjesëmarrja e shtetit është mbi 50%.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

INSPEKTORE E PËRGJITHSHME
Fatmira Laska

URDHËR
Nr.1, datë 13.1.2004

PËR MIRATIMIN E MODELIT TË DEKLARATËS SË PASURISË DHE AUTORIZIMIT PËRKATËS

Në mbështetje të ligjit nr.9049, datë 10.4.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë",

URDHËROJ:

1. Miratohet modeli i deklaratës së pasurisë dhe autorizimit përkatës për subjektet që mbartin detyrim për deklarim në zbatim të ligjit nr.9049, datë 10.4.2003, sipas modelit bashkëlidhur këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

INSPEKTORE E PËRGJITHSHME
Fatmira Laska

Inspektoriati i Larte i Deklarimit dhe Kontrollit te Pasurive
Tel : 228-516, 228-527

D E K L A R A T E
E
PERSONIT QE MBART DETYRIM PER DEKLARIM PASURIE

(Ligji 9049, date 10/04/2003, botuar ne Fletoren Zyrtare Nr.31, Maj 2003)

Model 5.1

Per tu plotesuar nga Deklaruesi

Emri	Mbiemri	Institucioni	Drejtoria/Sektori	Pozicioni/Titulli	Data e Emerimit	Data e Largimit
					___/___/____	___/___/____

Data e dorezimit te deklarates
___/___/____

Telefon / Cel.
_____

Tipi i deklarimit: →
1. Per here te pare ☐
2. Vjetori ☐
3. Me kerkese ☐
4. Pas largimit nga funksioni ☐

Numri total i faqeve te plotesuara nga une duke perfshire dhe kete faqe eshte: _____

Vertetoj se deklarimet e bera nga une ne formularet bashkelidhur jane te plota, te verteta, te sakta dhe mbaj pergjejgesi ligjore per saktesin e plotesimit te tyre

Deklaruesi
Emer, Mbiemer, Nenshkrim
.....

Adresa e plote e banimit:

Permbledhje e Formulareve

Formulari A-1 jo ☐ po ☐ – ne qofte se **po** ploteso kete formular bashkelidhur
Pasuri te paluajtshme dhe e drejta reale mbi to
Formulari A-2 jo ☐ po ☐ – ne qofte se **po** ploteso kete formular bashkelidhur
Pasuri te luajtshme me regjistrim publike
Formulari A-3 jo ☐ po ☐ – ne qofte se **po** ploteso kete formular bashkelidhur
Sende me vlere mbi 5000 USD
Formulari A-4 jo ☐ po ☐ – ne qofte se **po** ploteso kete formular bashkelidhur
Aksione, letra me vlere, pjese ne kapitale
Formulari A-5 jo ☐ po ☐ – ne qofte se **po** ploteso kete formular bashkelidhur
Likujditete (gjendje ne cash, ne llogari rrjedhese, ne depozite, ne bono thesari dhe ne huadhenie)
Formulari A-6 jo ☐ po ☐ – ne qofte se **po** ploteso kete formular bashkelidhur
Detyrime financiare ndaj personave juridik dhe fizike
Formulari A-7 jo ☐ po ☐ – ne qofte se **po** ploteso kete formular bashkelidhur
Te ardhura personale nga paga, pjesemarrja ne borde, komisione ose çdo veprimtari tjeter qe sjell te ardhura
Formulari A-8 jo ☐ po ☐ – ne qofte se **po** ploteso kete formular bashkelidhur
Licenca dhe patenta qe sjellin fitim

Per tu plotesuar nga Kontrolluesi

Data e marrjes ne dorezim
___/___/____

Emer, Mbiemer, Nenshkrim
.....

Ne baze te informacionit qe permbahet ne kete raport, une konkludoj se **formalisht** deklarata eshte e plotesuar
1. Ne rregull dhe pranohet ☐
2. Jo ne rregull, kthehet per plotesim ☐

→ Komente te marresit ne dorezim te deklarates

Data e verifikimit
___/___/____

Inspektori
Emer, Mbiemer, Nenshkrim
(.....)

Ne baze te verifikimeve te bera, deklarata rezulton:
1. E vertete ☐
2. Jo e vertete ☐
3. Me mangesi ☐

Nr. Indeksit (.....)

→ Komente te Inspektorit.

SQARIME PËR PLOTËSIMIN E FORMULARIT:

1. Formulari plotësohet nga subjekti që mbart detyrim për deklarim pasurie me mjete shkrimi me bojë ose me kompjuter, ndërsa emër, mbiemër dhe nënshkrim plotësohen me shkrim dore me bojë. Një emërtim mund ta shkruani në disa rreshta, vijat janë vetëm për orientim drejtshkrimi.

2. Plotësimi i formularit duhet të bëhet pa korrigjime, në të kundërt formulari është i pavlefshëm.

3. Në kolonën e parë "Përshkrimi" do të bëni përshkrimin në mënyrë të hollësishme të pasurisë që zotëroni, p.sh.: Tek formulari A-1 "Pasuri të paluajtshme dhe e drejta reale mbi to", ju do të shkruani (nëse zotëroni) fabrikë qelqi, apartament banimi ndërtuar para vitit 1990 me sipërfaqe 110 m^2 ose dyqan të vjetër ndërtuar para 1990 ose magazinë dhe aksesor ndërtuar pas vitit 1990 ose dyqan ushqimor ose minierë qymyrguri etj. të kësaj natyre.

4. Në kolonën e dytë "Sasia në natyrë" do të vendosni numrin e objekteve që zotëroni sipas përshkrimit përkatës etj., ndërsa në kolonën e emërtuar "Vlefta në milionë lekë" vendoset vlefta e objektit/ve në fund të periudhës ushtrimore për të cilën ju raportoni.

5. Në rubrikën "Vendndodhja" jepet adresa e plotë dhe e saktë, si p.sh. "Banka X" (adresa, nr.i llogarisë, shteti, rrethi, fshati etj.).

6. Në rubrikën "Burimi" bëhet përcaktimi konkret dhe jo i përgjithshëm si: trashëgimi ose dhuratë nga personi përkatës (emër mbiemër dhe adresa e tij e plotë), institucioni ose kompania, llogaria (numri dhe data e mandatpagesës), fitimet e realizuara për çdo vit etj. Për veprime me noteri, të regjistrohet emri mbiemri dhe adresë noteri.

7. Me termin "pasuri e paluajtshme" kuptohen objekte të palëvizshme, si: Toka, burimet e rrjedhjet e ujërave, drurët, adresat, ndërtimet e tjera notuese të lidhura me tokën dhe çdo gjë që është e trupëzuar në mënyrë të qëndrueshme e të vazhdueshme me tokën ose ndërtesën.

8. Me termin "të drejta reale" kuptojmë servitute, uzurfrute etj., sipas përcaktimit të Kodit Civil.

9. Me termin "pasuri e luajtshme me regjistrim publik" kuptohen objektet e lëvizshme, për të cilat është i detyrueshëm regjistrimi në një organ shtetëror, si në organet tatimore, drejtoritë rajonale të shfrytëzimit të automjeteve, kapiteneri të porteve, zyrat e regjistrit hekurudhor, ajror etj.

10. Me termin "sende me vlerë të veçantë mbi 5 000 USD" kuptojmë objekte arti, relike, objekte arkeologjike, shkencore ose kulturore, koleksione etj.

11. “Aksioni” është titull pronësie, që përfaqëson njërën nga pjesët në të cilat është ndarë kapitali i një shoqërie dhe që i jep të drejtën zotëruesit të saj të marrë pjesë në fitime.

12. "Persona të lidhur" janë të gjithë personat fizikë ose juridikë, të cilët nga kërkimet administrative rezultojnë të kenë pasuri ose të kenë lidhje pasurore me personin që mbart detyrimin për deklarim në njërën nga format e përcaktuara në ligj.

13. Formulari duhet të firmoset në fund të çdo faqeje, pastaj fotokopjohet. Origjinali mbyllet në zarf nga subjekti deklarues dhe i dorëzohet inspektoratit të ulët, ndërsa fotokopjen e mban vetë subjekti deklarues.

14. Në institucionet, në organet e drejtësisë etj. ku nuk ka inspektorat të ulët, deklarata do të dorëzohet te personi i ngarkuar me autorizim të titullarit, i cili është i detyruar të bëjë dorëzimin e deklaratave pranë Inspektoratit të Lartë.

15. Afati i dorëzimit të deklaratës është deri në 31 mars të çdo viti për gjendjen deri në 31 dhjetor të vitit paraardhës të pasurive, burimet e krijimit të tyre, si dhe detyrimet financiare, në të kundërt subjekti deklarues penalizohet sipas nenit 5 dhe 40 pika (a) të ligjit nr.9049, datë 4.10.2003.

Shënim.

- Për pasuritë e përmendura më sipër, deklarimi do të bëhet për veten tuaj dhe për të gjithë pjesëtarët e tjerë të familjes suaj që ju keni në ngarkim, sipas dokumentit të zyrës së gjendjes civile, burimin e krijimit, veprimtarinë në të cilën këto pasuri janë angazhuar, si dhe fitimin e nxjerrë prej tyre, qoftë dhe në rastin kur pronësia mbi ato pasuri është e pjesshme. Duhet deklaruar, gjithashtu, dhe e drejta reale mbi këto pasuri (d.m.th. pjesa e kësaj pasurie e zotëruar nga ju, bashkëshorti/bashkëshortja juaj, fëmijët dhe personat e tjerë që ju keni në ngarkim sipas dokumentit të zyrës së gjendjes civile).

- Kur pasuria e pjesëtarëve të familjes është e ndarë dhe e regjistruar si e tillë në organet e administratës shtetërore ose gjyqësore, deklarimi paraqitet veçmas nga çdo anëtar i familjes me të njëjtin format formular, të cilët i bashkëlidhen deklaratës së personit që ka detyrimin për deklarim.

- Në rast se deklaruesi ka persona të tjerë të lidhur, atëherë ai duhet të deklarojë edhe për ata në një formular më vete.

PËRBËRJA FAMILJARE, PJESËTARËT E FAMILJES ME PASURI TË REGJISTRUAR MË VETE DHE PERSONAT E TJERË TË LIDHUR ME SUBJEKTIN QË MBART DETYRIM PËR DEKLARIM

I. Përbërja familjare

Në bazë të regjistrit themeltar shtetëror të zyrës së gjendjes civile bashkia/komuna_____Përbërja ime familjare është si më poshtë vijon:

Nr.	Emër, mbiemër	Atësia	Datëlindja	Lidhja me deklaruesin	Gjendja civile	Vendbanimi (Adresa e plotë)
1						
2						
3						
4						
5						

II. Pjesëtar të familjes me pasuri të regjistruar më vete

Nr.	Emër, mbiemër	Lidhja me deklaruesin	Vendbanimi (Adresa e plotë)	Shënime
1				
2				
3				

Shënim.Pjesëtarët e mësipërm të familjes sime kanë plotësuar deklaratë më vete, e cila është bashkëlidhur.

III. Persona të tjerë të lidhur me pasuri të përbashkët me mua

Nr.	Emër, mbiemër	Lidhja me deklaruesin	Vendbanimi (Adresa e plotë)	Shënime
1				
2				
3				

Deklarimi i rremë i pasurisë dënohet sipas dispozitave përkatëse të Kodit Penal

Emër, mbiemër, firmë

FORMULARI A -1

PASURI TË PALUAJTSHME DHE E DREJTA REALE MBI TO

Si: Toka, burimet e rrjedhjet e ujërave, drurët, ndërtesat (dyqane, shtëpi banimi, magazina, fabrika, uzina, pikë karburanti etj.), ndërtimet e tjera notuese të lidhur me tokën dhe çdo gjë që është e trupëzuar në mënyrë të qëndrueshme e të vazhdueshme me tokën ose ndërtesën.

Periudha e deklarimit

Emër, mbiemër_____ Institucioni_____ Nga____/____/___ deri ___/___/___

Përshkrimi	Sasia në natyrë	Vlefta në milion/lekë	Pjesa që zotëron në %	Vendndodhja (adresa e plotë)	Nr. dt. regj. në hipotekë (nëse ka)	Nr. pasurisë	Burimi (konkret dhe jo i përgjithshëm)	Të ardhura vjetore në milion/lekë

Deklarimi i rremë i pasurisë dënohet sipas dispozitave përkatëse të Kodit Penal.

Emër, mbiemër, firmë

FORMULARI A -2

PASURI TË LUAJTSHME ME REGJISTRIM PUBLIK

Kuptohen objektet e lëvizshme për të cilat është i detyrueshëm regjistrimi në një organ shtetëror, siç janë: organet tatimore, drejtoritë rajonale të shfrytëzimit të automjeteve, kapiteneria e porteve, zyrat e regjistrit hekurudhor, ajror etj.

Emër, mbiemër_____ Institucioni_____ Periudha e deklarimit Nga____/____/___ deri ___/___/___

Përshkrimi	Sasia në natyrë	Vlefta në milion/lekë	Pjesa që zotëron në %	Vendndodhja (adresa e plotë)	Nr, dt. regj në regjistrat publikë	Burimi (konkret dhe jo i përgjithshëm)	Të ardhura vjetore në milion/lek

Deklarimi i rremë i pasurisë dënohet sipas dispozitave përkatëse të Kodit Penal. Emër, mbiemër, firmë

FORMULARI A -3

SENDE ME VLERË MBI 5000 USD

Me termin "sende me vlerë të veçantë mbi 5 000 USD" kuptojmë objekte arti, relike, objekte arkeologjike, shkencore ose kulturore, koleksione etj.

Periudha e deklarimit

Emër, mbiemër_____ Institucioni_____ Nga____/____/___ deri ___/___/___

Përshkrimi	Sasia në natyrë	Vlefta në milion/lekë	Vendndodhja (adresa e plotë)	Burimi	Vërejtje

Deklarimi i rremë i pasurisë dënohet sipas dispozitave përkatëse të Kodit Penal.

Emër, mbiemër, firmë

FORMULARI A -4
AKSIONE, LETRA ME VLERË, PJESË NË KAPITALE

"Aksioni" është titull pronësie, që përfaqëson njërën nga pjesët në të cilat është ndarë kapitali i një shoqërie dhe që i jep të drejtën zotëruesit të saj të marrë pjesë në fitime.

Emër, mbiemër_____ Institucioni_____

Periudha e deklarimit
Nga____/____/___ deri ___/___/___

Përshkrimi	Sasia në natyrë	Vlefta në milion/lekë	Vendndodhja (adresa e plotë)	Burimi	Të ardhura vjetore në milion/lekë

Deklarimi i rremë i pasurisë dënohet sipas dispozitave përkatëse të Kodit Penal.

Emër, mbiemër, firmë

FORMULARI A -5

LIKUIDITETE

Me termin "likuiditete" kuptohet gjendja në *cash*, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie.

Periudha e deklarimit

Emër, mbiemër_____ Institucioni_____ Nga____/____/___ deri ___/___/___

Përshkrimi	Vlefta në milion/lekë ose valutë	Vendndodhja (adresa e plotë)	Burimi	Të ardhura vjetore në milion/lekë ose valutë

Deklarimi i rremë i pasurisë dënohet sipas dispozitave përkatëse të Kodit Penal.

Emër, mbiemër, firmë

FORMULARI A -6

Të ardhura personale nga paga, pjesëmarrja në borde, komisione ose çdo veprimtari tjetër që sjell të ardhura
(Për vete dhe të gjithë pjestarët e familjes)

Periudha e deklarimit

Emër, mbiemër_____ Institucioni_____ Nga____/____/___ deri ___/___/___

Përshkrimi	Shuma gjithsej milion/lek	Detyrime Fiskale në milion/lek	Shuma neto në milion/lekë	Adresa e plotë e institucionit ku realizohen të ardhurat

Deklarimi i rremë i pasurisë dënohet sipas dispozitave përkatëse të Kodit Penal.

Emër, mbiemër, firmë

FORMULARI A -7
LICENCA DHE PATENTA QË SJELLIN FITIM

Periudha e deklarimit

Emër, mbiemër_____ Institucioni_____ Nga____/____/___ deri ___/___/___

Përshkrimi	Sasia në natyrë	Vlefta në milion/lekë	Vendndodhja (adresa e plotë)	Shuma gjithsej milion/lekë	Detyrime fiskale në milion/lekë	Shuma neto në milion/lekë	Vërejtje

Deklarimi i rremë i pasurisë dënohet sipas dispozitave përkatëse të Kodit Penal.

Emër, mbiemër, firmë

FORMULARI A -8
DETYRIMET FINANCIARE NDAJ PERSONAVE JURIDIKË DHE FIZIKË

Periudha e deklarimit

Emër, mbiemër_____ Institucioni_____ Nga____/____/___ deri ___/___/___

Përshkrimi	Vlefta në milion/lekë	Vendndodhja e subjekteve që ju detyroheni (adresa e plotë)	Arsyeja e krijimit të detyrimit	Vërejtje

Deklarimi i rremë i pasurisë dënohet sipas dispozitave përkatëse të Kodit Penal.

Emër, mbiemër, firmë

AUTORIZIM
PËR KONTROLL TË DEKLARIMIT TË PASURISË

Në zbatim të nenit 10 të ligjit nr.9049, datë 10.4.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", unë_____si subjekt i detyrimit për deklarim të pasurisë, nën përgjegjësinë time personale, autorizoj Inspektoratin e Lartë/të Ulët të ushtrojë kontroll mbi vërtetësinë, saktësinë dhe burimet e pasurive të mia, që ndodhen brenda dhe jashtë vendit në të gjitha subjektet publike dhe private të deklaruara në formularët A1 deri në A8, bashkëlidhur këtij autorizimi.

Autorizuesi

Datë ____/_____/_____

Emër, mbiemër, firmë
(_____)

URDHËR
Nr.2, datë 13.1.2004

PËR MIRATIMIN E MODELIT TË REGJISTRIT THEMELTAR ALFABETIK TË SUBJEKTEVE QË MBARTIN DETYRIM PËR TË DEKLARUAR NË INSPEKTORATIN E LARTË DHE INSPEKTORATIN E ULËT

Në mbështetje të ligjit nr.9049, datë 10.4.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë",

URDHËROJ:

1. Miratohet modeli i regjistrit themeltar alfabetik të subjekteve që mbartin detyrim për të deklaruar në Inspektoratin e Lartë dhe Inspektoratin e Ulët, në zbatim të ligjit nr.9049, datë 10.4.2003, sipas modelit bashkëlidhur këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

INSPEKTORE E PËRGJITHSHME
Fatmira Laska

REGJISTRI THEMELTAR ALFABETIK PËR SUBJEKTET QË MBARTIN DETYRIM PËR DEKLARIM TË PASURIVE
(PËR INSPEKTORATIN E ULËT)

Nr.	Emër mbiemër	Funksioni	Dt. Emërim	Dt. Largim	Data e deklarimit sipas viteve								Shënime	Alfabetiku

REGJISTRI THEMELTAR ALFABETIK PËR SUBJEKTET QË MBARTIN DETYRIM PËR DEKLARIM TË PASURIVE
(PËR INSPEKTORATIN E LARTË)

Nr.	Emër mbiemër	Funksioni	Dt. Emërim	Dt. Largim	Data e deklarimit sipas viteve								Shënime	Alfabetiku

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
  Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë **Qendrës së Publikimeve Zyrtare** mund të gjeni:

LISTA E BOTIMEVE TË AZHURNUARA DERI NË JANAR 2004

1.	KUSHTETUTA	600
2.	KODI I PROCEDURËS CIVILE	500
3.	KODI I PROCEDURËS PENALE	600
4.	KODI PENAL	400
5.	KODI I PUNËS	500
6.	KODI I FAMILJES	450
7.	KODI CIVIL	1000
8.	KODI RRUGOR	900
9.	KODI ZGJEDHOR	355
10.	KODI RRUGOR (Dispozita zbatuese)	1500

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

12.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT	800
13.	PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK	1000

BOTIME TË REJA

14.	KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	500
15.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL	600

Së shpejti në botim, përmbledhje në fushën e taksave dhe tatimeve

Doli nga shtypi më 27.1.2004

Tirazhi: 4500 copë	Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2004

Çmimi: 150 lekë